

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit Q. R., nga fshati K., Komuna e P., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me paragraf 1 te KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.964-3/2016 të datës 18.07.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Elfete Purova, dhe të akuzuarit, me datë 07.02.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

Q. R., nga i ati R. dhe nëna Y. e lindur B., i lindur me datën *data e lindjes...* në P., tani jeton në fshatin K., Komuna e P., ka të kryer shkollën e mesme, student, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 16.04.2016 rreth orës 17,40 minuta, në rrugën magjistrale P. – Zh., në fshatin V., nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, duke drejtuar automjetin e markës “VW Golf”, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, ngjyrë e kaltër, vepron në kundërshtim rregullat e komunikacionit, në atë mënyrë që nuk i jep përparësi kalimi automjeteve të cilët lëviznin në rrugën me përparësi kalimi, me të arritur te udhëkryqi që lidhet me rrugën magjistrale M25, fillon të kyçet në rrugën kryesore në drejtim të Prizrenit, ku goditet në pjesën e parme të anës së majtë nga automjeti i markës “Reno Clio” me targa të regjistrimit *numri i targës...*, ngjyrë e bardhë, të cilën e drejtonte në drejtimin e tij të lëvizjes i dëmtuari B. H., i cili në momentin që vëren automjetin e të pandehurit që trupon rrugën, me qëllim të shmangies së aksidentit, kalon në shiritin e kundërt të drejtimit të lëvizjes, ku pos dëmeve materiale në automjete lëndime të lehta trupore pësojnë bashkë udhëtarët në automjetin e të pandehurit të dëmtuarit: D. Rr. dhe L. Rr., si dhe vozitësi i automjetit “Reno Clio”, i dëmtuari B. H., lëndime të cilët janë të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko ligjor Dr. V. K., të datës 01.06.2016,

Këso dore ka kryer veprën penale të rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me paragraf 1 te KP-ës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-ës, te akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale,

I dëmtuari: L. Rr., nga fshati K., Komuna e P., për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari qe ti paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe ate në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 50,00 Euro, si dhe në emër të ekspertizës të komunikacionit shumë prej 40,88 Euro, dhe në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.964-3/2016 të datës 18.07.2016, kundër të akuzuarit Q. Rr., nga fshati K., Komuna e P., për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 te KP-ës,

Prokurori i shtetit Elfete Purova, në fjalën e saj përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.964/2016 të datës 18.07.2016, kundër të akuzuarit Q. R., nga fshati K., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

I dëmtuari B. H., nga babai F., dhe nëna H. e lindur K., i lindur me datën *data e lindjes...* në P., tani jeton në fshatin V., Komuna e P., deklaron që si palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pronësore juridike.

I dëmtuari D. Rr., nga babai R. dhe nëna Y. e lidhur B., i lindur me datën *data e lindjes...* në P., tani jeton në fshatin K., Komuna e Prizrenit, deklaron që si palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pronësore juridike.

I akuzuari Q. R., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj veprën penale cila më vihet në barë, unë në ditën kritike kam qarkulluar me automjetin tim të markës “VW Golf”, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, dhe me të arritur tek vendi për kyçje në rrugën kryesore në drejtim të Prizrenit, e cila lidhet me rrugën magjistrale M-25, e kam vërejtur automjetin e markës “Reno Clio”, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, të cilën e drejtonte këtu i dëmtuari B. H., por lehtas kam menduar që mund të vazhdoj veprimet e mia për kyçjen në rrugë kryesore pa e penguar automjetin e cekur të dëmtuarit, dhe me rastin e ndërmarrjes së veprimit, ka ardhur deri te aksidenti i komunikacionit. Andaj nga të cekurat edhe e pranoj veprën penale e cila më vihet

në barë, por i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, rrethanat e mia personale, moshën time të re, dhe se vepra penale e cila më vihet në barë është shkaktuar pa dëshirën dhe vullnetim tim, nuk ka ekzistuar qëllimi për kryerjen e veprës penale, e tëra ka ndodhur në mënyrë spontane, e vetmja barë e imja e fajësisë është mendjelehtësia që nuk kam kontrolluar sigurt sigurimin në komunikacion para veprimit të ndërmarrë. Të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 16.04.2016 rreth orës 17,40 minuta, në rrugën magjistrale P. – Zh., në fshatin V., i akuzuari nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, duke drejtuar automjetin e markës “VW Golf”, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, ngjyrë e kaltër, vepron në kundërshtim rregullat e komunikacionit, në atë mënyrë që nuk i jep përparësi kalimi automjeteve të cilët lëviznin në rrugën me përparësi kalimi, me të arritur te udhëkryqi që lidhet me rrugën magjistrale M25, fillon të kyçet në rrugën kryesore në drejtim të Prizrenit, ku goditet në pjesën e parme të anës së majtë nga automjeti i markës “Reno Clio” me targa të regjistrimit *numri i targës...*, ngjyrë e bardhë, të cilën e drejtonte në drejtimin e tij të lëvizjes i dëmtuari B. H., i cili në momentin që vëren automjetin e të pandehurit që trupon rrugën, me qëllim të shmangies së aksidentit, kalon në shiritin e kundërt të drejtimit të lëvizjes, ku pos dëmeve materiale në automjete lëndime të lehta trupore pësojnë bashkë udhëtarët në automjetin e të pandehurit të dëmtuarit: D. Rr. dhe L. Rr., si dhe vozitësi i automjetit “Reno Clio”, i dëmtuari B. H., lëndime të cilët janë të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko ligjor Dr. V. K., të datës 01.06.2016,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kusht, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në

momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoreshë juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1517/2016 me datë 07.02.2017

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.